

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE DURRËS

Raporti përfundimtar i auditimit ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm” për periudhën 01.10.2013 – 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 173, datë 28.12.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 715/16, datë 28.12.2015, i është dërguar DRT Durrës dhe me shkresën nr. 715/17, datë 28.12.2015 Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet” për marrjen e masave.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional u konstatua se në dosjet e kontrollit të tatim fitimit për subjektet e kontrolluara, mungojnë letrat e punës për një analizë të detajuar të të ardhurave e shpenzimeve mbi të cilat arrihet rezultati i kontrollit, fakt që bie në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor pika TP 4.3 por edhe krijojnë vështirësi për vlerësimin e punës së këtij sektori nga ana jonë si auditues.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 89-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, të përgatitet një format ku të kërkohej konsolidimi i praktikës së kontrollit për tatim fitimin dhe të përcaktohet si detyruese e plotësuese që për çdo raport kontrolli të bëhet një analizë më e hollësishme e shpenzimeve të subjektit duke i ndarë shpenzimet me faturë dhe shpenzimet e pa deklaruara në FDP për të mundësuar rakordimin midis blerjeve të deklaruara në FDP dhe shpenzimeve në bilanc.

Afati: në Vazhdimësi

2. Duke u nisur nga numri i lartë i subjekteve që ushtrojnë aktivitet nën regjimin e përpunimit aktiv nga Grupi i Auditimit u vlerësua se në tre praktika kontrolli veprimet e ndjekur për monitorimin e këtyre subjekteve nga Drejtoria e Kontrollit Operacional, bënin të pamundur evidentimin, ndjekjen dhe vlerësimin e bilancit material dhe reflektimi i tij në rezultatin financiar. Përgjithësisht inspektorët e kontrollit bazoheshin në të dhënat e vetë deklaruara të subjektit duke anashkaluar vlerën reale dhe lënë hapësira për shmangie tatimore.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 89-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nga DRT Durrës, në procedurën dhe raportet e kontrollit operacional, të vlerësohet rezultati financiar duke ju referuar në çdo rast vlerësimin të bilancit material për të prerë rrugën e veprimeve abuzive të subjekteve objekt kontrolli.

Afati: në vazhdimësi

3. Nga auditimi në Drejtorinë e Mbledhjes së Borxhit rezultoi se detyrimet e papaguara në fund të vitit 2013 krahasuar me fillimin e vitit janë rritur në masën 11,9 %, ndërsa në fund të vitit 2014 krahasuar me fillimin e vitit janë rritur në masën 11,6 %.

Masat shtrënguese të marra gjatë vitit 2013-2014 nuk kanë siguruar zvogëlim të gjendjes së borxhit në këto vite si në numër subjektesh ashtu edhe në vlerë. Në totalin e masave shtrënguese peshën kryesore e zënë masa Urdhër Bllokimi i Llogarive Bankare.

DRT Durrës nuk ka zbatuar rast pas rasti masat shtrënguese të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 88-101, si dhe kërkesat Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, të Miratuar nga Ministri i Financave, për arkëtimin e borxhit tatimor **në vlerë 8,913,660 mijë lekë**, sipas afateve ligjore të përcaktuara në legjislacionin tatimor.

Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 140-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, të bëjë një raport të hollësishëm të të gjithë subjekteve debitorë dhe detyrimeve të tyre, të ndara në detyrime e penaltete dhe të adresohet në DPT me një plan të detajuar mbi mundësitë e brendshme për të vënë në kontroll nivelet e rritura të borxhit tatimor, si dhe ti kërkojë DPT, një mënyrë procedimi për rastet e shoqërive me pamundësi financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Afati: Menjëherë

4. Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për periudhën objekt auditimi u konstatua se ka mungesa të theksuara në organikë kështu: nga 128 punonjës në organikë për vitet 2013 dhe 2014, aktualisht ka patur 98 punonjës. Gjatë zbatimit të detyrave funksionale dhe detyrave të urdhëruara nga DPT stafi është qarkulluar në disa pozicione duke e shoqëruar me mbivendosje detyrash gjë që ka sjellë rendiment të ulët në punë dhe ulje rezultati në mbledhjen e detyrimeve tatimore. Për mbarëvajtjen e punës janë kryer lëvizje paralele brenda organikës duke shtuar numrin punonjësve në Sektorin e Terrenit me 20 punonjës nga të cilët 8 nga Sektori i Kontrollit Operacional dhe 12 nga Sektori i Vlerësimit, duke dobësuar punën në këta sektorë.

Për sa më sipër, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nisur nga risku operacional i shfaqur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante për tu normalizuar aktiviteti në këtë Drejtori.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI:

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, marrjen në shqyrtim të tyre, në lidhje me detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuar, të cilat në total janë në **shumën 282,123,777 lekë**, për praktikat e mëposhtme:

1. Për 16 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2013 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penaltetesh në **shumën 48,921,767 lekë**, sipas aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (Trajtuar në faqet 34-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Afati: deri në datë 30.04.2016

2. Për 17 raste (subjekte), për periudhën tatimore të vitit 2014 për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penaltetesh në **shumën 50,111,569 lekë**, sipas aneksit nr. 2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime në kundërshtim me ligjin nr.8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (Trajtuar në faqet 34-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Afati: deri në datë 30.04.2016

3. Për 299 raste, në **shumën 35,787,448 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 3, nr. 4, nr. 5 dhe nr. 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për shkelje të procedurave si dhe fshehje dhe shmangie nga pagimi i detyrimeve, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e neneve 126 dhe 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe neneve 33 dhe 33.1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar *(Trajtuar në faqen 34-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: deri në datë 31.03.2016

4. Për 30 raste, në **shumën 6,156,176 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 7 dhe nr.8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga ballafaqimi i të dhënave të Degëve të Thesarit me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës janë konstatuar veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 116.1 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar *(Trajtuar në faqen 147-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: deri në datë 30.04.2016

5. Për 23 raste (subjekte), të mos vendosjen e penaliteteve në **shumën 50,617,552 lekë**, sipas aneksit nr. 9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” *(Trajtuar në faqen 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: deri në datë 30.04.2016

6. Për 23 raste (subjekte), të mos llogaritjes së detyrimeve në **shumën 35,226,632 lekë**, sipas aneksit nr. 9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar *(Trajtuar në faqen 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: deri në datë 30.04.2016

7. Për 23 raste (subjekte), të mos llogaritjes së detyrimeve në **shumën 32,244,413 lekë**, sipas aneksit nr. 9, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar *(Trajtuar në faqen 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: deri në datë 30.04.2016

8. Në 6 raste për **shumën 80,000 lekë** sipas aneksit nr.10, të Raportit Përfundimtar të auditimit, për mos vendosjen e penaliteteve dhe mosdhënie informacioni në zbatim të ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenit 126 *(Trajtuar në faqen 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: Menjëherë

9. Nga subjekti . [REDAKTUAR] për **shumën 19,528,220 lekë** si penalitete në zbatim të ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, nenin 116 pika 1 dhe ligjit nr.10033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” *(Trajtuar në faqen 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: Menjëherë

10. Në tre raste për **shumën 540,000 lekë** sipas aneksit nr. 11, Raportit Përfundimtar të Auditimit, për mos vendosje penalteti në përputhje e zbatim të ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar *(Trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit)*.

Afati: Menjëherë

11. Në 19 raste për **shumën 2,910,000 lekë**, sipas aneksit nr. 12, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për mos aplikim të penalteteve në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar nenin 112.1 germa “ii” (*Trajtuar në faqen 130-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Afati: deri në datë 30.04.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Durrës, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 dhe nenit 58 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masës, sipas nenit 59.2: “*pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*” për 21 nëpunës, nga të cilët:

10 punonjës me detyrë Inspektorë në Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit;

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot, datë 04.10.2010 për mos përmbushje të detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

* jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

* jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 28-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4 punonjës me detyrë Inspektorë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor;

Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar, nenet 53, 59,71, 115, 116, 117, 118, 120, 124, 128 dhe Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar; ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH” i ndryshuar nenet 27, 33, 41, dhe Udhëzimin të Ministrit të Financave nr. 17, datë 13.05.2008 i ndryshuar; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, nenit 20,21, 33/1; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 03.05.2010 përkatësisht: Pika 2/5, dhe nr. 15 si dhe kërkesat e Manualit të Kontrollit miratuar me nr. 5045, datë 22.02.2011 (*Trajtuar hollësisht në faqet 89-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6 punonjës me detyrë Inspektorë në Sektorin e Terrenit dhe

1 punonkës me detyrë përgjegjës i Sektorit të Verifikimit në Terren.

(Trajtuar hollësisht në faqet 130-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për mos vendosje të penalteteve konform dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008” Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, që ka sjellë për pasojë efekt financiar me të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Për 6 ish punonjës nuk janë rekomanduar masa disiplinore, për arsye se kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 173, datë 28.12.2015, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 17.08.2015 deri më 20.11.2015, nga audituesit shtetëror: Albana Agolli, përgjegjëse grupi, Artan Mirashi, Aqif Klosi, Hekuran Avdulaj, Elida Koçani, Joniada Goçaj, anëtare, u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, me shkresat nr. 14554/152, datë 14.01.2016 dhe nr. 14554/154, datë 18.01.2016 i është kthyer përgjigje KLSH për masat e marra nga kjo Drejtori për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, hartimin e Planveprimit, ku janë përcaktuar Departamentet përgjegjëse dhe afatet për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT